

Vendim Nr.5 datë 9.01.2020

PËR EMËRIMIN GJYQTAR TË Z. ARTUR PRENGA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136/a dhe 147/a, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 35 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja "a", nenin 86, shkronja "a" dhe nenin 97, pika 1, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin nr.233, datë 24.10.2019, "Për kualifikimin e kandidatit z. Artur Prenga dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtar", mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I :

Të emërojë gjyqtar z. Artur Prenga.

Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit të emëruar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR